



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	27-05-2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHCK	8130/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.394/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar , Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtar si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.394/2022 të datës 19.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër Vendimit me numër protokollit 4998 të datës 21.07.2021 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike “pezullim parandalues”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.394/2022, e datës 19.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, sipas akt emërimit të datës 01.01.2017, në pozitën “Inspektor” ne Regjionin e Prishtinës, bazuar në shkresën me nr.dokumenti 01433698 të datës 15.07.2021 të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, Zëvendësuesi Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me Vendimin me numër protokollit 4998 të datës 21.07.2021 ka pezulluar nga puna ankuesin për arsye se ndaj ankuesit me datën 30.06.2021 është caktuar masa e paraburgimit me dyshimin se i njëjti ka kryer veprën penale nga neni 414 dhe 419 të Kodit Penal.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër Ref.AZHB-07/4/1/103/2021 të datës 21.07.2021 të Zëvendësuesit të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë lidhur me pezullimin nga puna, të pranuar më datë 15/04/2022, me datë 19.04.2022 dhe numër të protokollit



2194/2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (tutje AZHB), ndërsa kjo e fundit me datën 13.05.2022 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli: 2194/2022 të datës 19.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 4998 të datës 21.07.2021 të Zëvendësuesit të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Shkresën me numër 116 të datës 15.04.2022 lidhur me pranimin e vendimit për pezullim nga ankuesi; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.01.2017; Raportin vjetor të punës së ankuesit të datës 01.12.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 13.05.2022 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Shkresën zyrtare të datës 23.08.2021 lidhur me shqyrtimin e kërkesës për inicim disiplinor nga Komisioni Disiplinor; E-mailin zyrtar të datës 23.08.2021; Njoftimin me numër PP/I nr.8K/21 të datës 15.07.2021 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Procesverbalin e datës 30.08.2021 nga Komisioni Disiplinor; Vendimin me numër 5538 të datës 30.08.2021 nga Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Librin e pranimit të datës 31.08.2021; E-mailin zyrtar të datës 13.05.2022; E-mailin zyrtar te datës 25.02.2022; E-mailin zyrtar të datës 24.02.2022; E-mailat zyrtar te datës 25.02.2022; E-mailin zyrtar te datës 24.02.2022; Procesverbalin e datës 22.02.2022 nga Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Vendimin me numër 935 të datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit me numër 5538 te datës 30.08.2021 nga Komisioni Disiplinor; Kërkesën e datës me numër 3034/2022 lidhur me provat shtesë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër 3035/2022 në provat shtesë të datës 25.05.2022 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Regjistrin e pranimit të dërgesave postare me kredi të datës 31.08.2021 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se objekti për të cilin ishte nisur procedura administrative në lidhje me këtë ankesë A.nr.394/2022, të datës 19.04.2022 **është bërë i pamundur apo i kotë** andaj edhe mbi këtë bazë ligjore Kolegji merr vendim për **Përfundim të Procedimit Administrativ, SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka konstatuar se ankesa e parashtruar në Këshill ka të bëjë ndaj Vendimit Nr.prot.4998 të datës 21.07.2021 i nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë që ka të bëjë me pezullim nga puna dhe i pranuar më datë 15/04/2022, ndërsa ndërlidhur me këtë vendim duke u bazuar në shkresat e lëndës të ofruara nga palët, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se



Vendimi Ref.07/04/130/2021 me numër të protokollit Nr.Prot.5538 i datës 30.08.2021, i nxjerrë nga Komisioni Disiplinor në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë lidhur me pezullimin e ankuesit nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës, në pikën 4 e ka shfuqizuar Vendimin Ref.AZHB-07/4/1/103/2021 me numër protokollit Nr.Prot.4998 i datës 21.07.2021 i nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë që është objekt i kësaj ankese dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë objekti për të cilin kishte filluar procedimi administrativ lidhur me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, nga ajo që u konstatua më lartë tashmë vendimi që është objekt i kësaj ankese është shfuqizuar nga komisioni disiplinor i organit të punësimit dhe nuk ka asnjë efekt juridik në momentin e parashtrimit të kësaj ankese.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.394/2022, datë 27.05.2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencisë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

